

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.F.V - banderolash me dy faqe per festa zyrtare e fetare.

1.1.Volumet e punimeve.

Bashkia ka parashikuar paraprakisht numrin e banderolave **27 cope** ne vit, pershkrimin e punimeve dhe specifikimet e tyre, ne analizen e kostos Nr.1, te parashikuara per festat zyrtare e fetare.

Keto banderola vendosen ne ambjente publike dhe me efekt vizual te qytetaret, sipas pikave te vendosjes se tyre ne zonen e sherbimit te qytetit Kucove.

1.2.Specifikimet teknike dhe metodologjia

a.Sherbimi i vendosjes se banderolave me dy faqe behet per festat e meposhtme ne vit :

- Viti i Ri dhe Krishtlindjet - 3 cope
- Festa e Kurban Bajramit - 3 cope
- Festa e Sulltan Nev - Ruzit (Dita e Re) - 3 cope
- Festa e Pashkeve (Katolike e Ortodokse) - 3 cope
- Festa e “5 Majit” - Dita e Deshmoreve - 3 cope
- Festa “Per ju Emigrante” dhe “11 Shkurti” - 3 cope
- Festa e “18 Tetorit”, Çlirimi i Kucoves - 3 cope
- Festa e “Nene Terezes” - 3 cope
- Festat e “28 – 29 Nentorit” - 3 cope

b.Banderolat jane me dy faqe, te cilat shkruhen nga te dy anet me shkrim te qarte te mesatarizuar.Gjatesia e tyre eshte 12-12,5 ml, ndersa gjeresia eshte 0.6 ml dhe fiksimi i tyre behet ne shtylla metalike te vendosura per kete qellim, ne vendet e caktuara nga Bashkia te permendura me lart, me shkop e litare ne lartesi rreth 5 m, per te mos u demtuar nga automjetet me lartesi te madhe.

1.3.Plani i vendosjes se banderolave dhe grafiku i punimeve.

a.Bashkia do te percaktoje, ne fillim te kesaj kontrate, pikat ekzakete te vendosjes se banderolave, te cilat jane si me poshte:

- Ne fund te Bulevardit kryesor, sheshi para Komunales
- Te sheshi “18 Tetori” sheshi para Bashkise
- Te sheshi i Pazarit qendra tregtare e qytetit

Plani i vendosjes se banderolave mund te ndryshoje gjate kohes se zbatimit te kontrates nga Bashkia, sipas nevojave per permiresimin e sherbimit te dekorit, ose si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture.

b.Kontraktuesi eshte i detyruar te zbatoje planin fillestar te pikave te vendosjes se banderolave, si dhe cdo ndryshim te tyre, pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate.Ne te gjitha rastet kur kontraktuesi ka nevojte per te permiresuar sherbimin dhe mireorganizuar ate,mund te kerkoje zyrtarisht prane Bashkise ndryshime, te cilat behen te zbatueshme pas miratimit te kerkeses.

c.Grafiku vjetor i punimeve per vendosjen e banderolave per festat zyrtare e fetare eshte i percaktuar per cdo feste te vecante zyrtare apo fetare si me poshte:

- Banderolat duhet te vendosen 2-3 dite para festes zyrtare dhe fetare dhe do te hiqen 1-2 dite pas dates se festes.

- oraret e punes se vendosjes se tyre do te jene nga ora 06.⁰⁰-07.⁰⁰ dhe 14.⁰⁰-16.⁰⁰, kohe qe nuk ka levizje te medha te automjeteve.
- e. Bashkia ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe grafikun e punimeve dhe ne perfundim vendet e vendosjes se banderolave per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.

1.4. Rregulla per tu zbatuar.

- a. Kontraktuesi duhet te siguroje vendosjen e banderolave ne lartesine e duhur, per t'i ruajtur ato nga demtimet e mundshme te kamionave te medhenj.
- b. Ne te gjitha rastet kur evidentohen demtime te banderolave nga automjete apo nga faktore te tjere te jashtem, kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per zevendesimin e tyre jo me vone se 5 ore nga marrja e njoftimit. Ne rast te kundert, pergjegjesia eshte e kontraktuesit dhe do te vendosen penalitete sipas ligjit.

1.5. Mjetet dhe Paisjet.

Kontraktuesi duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, vendosjes se banderolave dhe te gjitha sherbimeve plotesuese keto mjete dhe pajisje:

1. Automjet per transportin e bazes materiale
2. Shkalle te sigurta me lartesi 5-6m (metalike ose druri)

2.F.V - flamujsh festiv per festa zyrtare.

2.1. Volumet e punimeve.

Bashkia ka parashikuar paraprakisht numrin e flamujve **40 cope** ne vit, pershkrimin e punimeve dhe specifikimet e tyre, ne analizen e koston Nr.2, te parashikuara per festat zyrtare. Flamujt vendosen ne ambiente publike, rruge e sheshe kryesore dhe me efekt vizual te qytetaret, sipas pikave te vendosjes se tyre ne zonen e sherbimit te qytetit Kucove.

2.2. Specifikimet teknike dhe metodologjia

a. Sherbimi i vendosjes se flamujve, qe ne shumicen e rasteve shoqerohet me vendosjen e banderolave, behet per festat zyrtare gjate vitit:

- Festa e 5 Majit - "Dita e Deshmoreve"
 - Festa "Per ju Emigrante"
 - Perkuajtimi i Greves se Kucoves "11 shkurt"
 - Festa e "18 Tetorit", Çlirimi i Kucoves
 - Festa e "Nene Terezes"
 - Festat e "28 – 29 Nentorit"
- b. Flamujt jane prodhuar prej akllasi te kuq, ata kane te vizatuar shqiponjen, me boje te zeze. Gjatesia e tyre eshte 2,5 ml, ndersa gjeresia eshte 0.6-0.8 ml dhe fiksimi i tyre behet ne shtylla metalike te rrjetit te ndricimit publik, ne rruget kryesore dhe sheshet e caktuara nga Bashkia, me shkop e litare ne lartesi rreth 4m, per te mos u demtuar nga femije apo njerez te papergjegjshem.

2.3. Plani i vendosjes se flamujve.

a. Bashkia do te percaktoje, ne fillim te kesaj kontrate, pikat ekzakte te vendosjes se flamujve, te cilat jane si me poshte:

- Te Lapidari kushtuar Çlirimit te Kucoves te Kryqezimi ne hyrje te qytetit
- Gjate Bulevardit kryesor, sheshi para Komunales deri te Bashkia
- Te sheshi “18 Tetori” sheshi para Bashkise
- Te sheshi i Pazarit qendra tregtare e qytetit
- Te sheshi i lagjes “11 Janari”
- Rruga nga sheshi para Bashkise deri te sheshi i Pazarit

Plani i vendosjes se flamujve mund te ndryshoje gjate kohes se zbatimit te kontrates nga Bashkia, sipas nevojave per permiresimin e sherbimit te dekorit, ose si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture.

b. Kontraktuesi eshte i detyruar te zbatoje planin fillestar te pikave te vendosjes se flamujve, si dhe cdo ndryshim te tyre, pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate. Ne te gjitha rastet kur kontraktuesi ka nevojë per te permiresuar sherbimin dhe mireorganizuar ate, mund te kerkoje zyrtarisht prane Bashkise ndryshime, te cilat behen te zbatueshme pas miratimit te kerkeses.

c. Grafiku vjetor i punimeve per vendosjen e flamujve per festat zyrtare eshte i percaktuar per cdo feste te vecante zyrtare si me poshte:

- Flamujt duhet te vendosen 2-3 dite para festes zyrtare dhe do te hiqen 1-2 dite pas dates se festes.
- oraret e punes se vendosjes se tyre do te jene nga ora 06.⁰⁰-07.⁰⁰ dhe 14.⁰⁰-16.⁰⁰, kohe qe nuk ka levizje te medha te automjeteve.

e. Bashkia ka te drejte te inspektojë ne cdo kohe grafikun e punimeve dhe ne perfundim vendet e vendosjes se flamujve per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.

2.4. Rregulla per tu zbatuar.

a. Kontraktuesi duhet te siguroje vendosjen e flamujve ne lartesine e duhur, per t'i ruajtur ato nga demtimet e mundshme te personave te papergjegjshem

b. Ne te gjitha rastet kur evidentohen demtime te flamujve nga persona te papergjegjshem apo nga faktore te tjere te jashtem, kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per zevendesimin e tyre jo me vone se 5 ore nga marrja e njoftimit. Ne rast te kundert, pergjegjesia eshte e kontraktuesit dhe do te vendosen penalitete sipas ligjit.

2.5. Mjetet dhe Paisjet.

Kontraktuesi duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, vendosjes se flamujve dhe te gjitha sherbimeve plotesuese keto mjete dhe pajisje:

3. Automjet per transportin e bazes materiale
4. Shkalle te sigurta me lartesi 5-6m (metalike ose druri)

3.F.V - vijezim rruge per automjete dhe kembesore.

3.1.Volumet e punimeve.

Bashkia ka parashikuar te behen vijezime per automjete **4 200 ml dhe 540 m²** per kembesore ne vit, pershkrimin e punimeve dhe specifikimet e tyre, ne analizen e kosos Nr.3 dhe Nr.4 , te parashikuara per t'u bere ne rruget kryesore te qytetit.

3.2.Specifikimet teknike dhe metodologjia

a.Sherbimi i vijezimit te rrugeve per automjete dhe kembesore behet nje here ne vit, kryesisht ne stinen e veres, per te rregulluar qarkullimine automjeteve gjate levizjes se tyre brenda qytetit si dhe vend parkimet e tyre:

- Vijezime ne rruge
- Vijezime ne vend parkime
- Vijezime per kembesore

b.Vijezimet ne rruge per automjete behen ne rruge e sheshe kryesore te qytetit, ku infrastruktura eshte e mire dhe qarkullimi i mjeteve eshte me i madh, me boje te bardhe plastike, e vecante vetem per vijezime ne rruge.

Vijezimet ne rruge per automjete jane parashikuar me nje normative prej 0,35 kg boje per 1 ml. Vijezimet behen me rul dhe gjatesia e tyre eshte standart, sipas Kodit Rrugor te RSH per sinjalistiken horizontale, gjeresia eshte 10 - 12 cm.Per berjen e tyre ne menyre te sakte perdoret spango dhe shabllon prej druri ose metalik.

Vijezimet ne rruge per kembesore jane parashikuar me nje normative prej 0,5 kg boje per 1 m². Edhe keto vijezime behen me rul me gjatesi prej 2 m dhe gjeresi prej 0,5 m.Keto vijezime behen ne kryqezimet kryesore per te rregulluar trafikun e qytetareve gjate kalimeve ne kryqezimet e rrugeve.Gjithashtu per berjen e tyre ne menyre te sakte perdoret spango dhe shabllon prej druri ose metalik.

3.3.Plani i berjes se vijezimeve per automjete e kembesore dhe grafiku i punimeve.

a.Bashkia do te percaktoje, ne fillim te kesaj kontrate, rruget kryesore e sheshet ku do te behen vijezimet per mjetet dhe vend parkimet e tyre si dhe kryqezimet kryesore per vijezimet e kembesoreve, te cilat jane si me poshte:

- Bulevardi kryesor, sheshi para Komunales deri te Bashkia
- Rruga nga sheshi para Bashkise - shtepite e Dibraneve - Gjimnaz
- Rruga sheshi para Bashkise sheshi i Pazarit - Fotograf - Mapo
- Rruga nga Tregu i Ri te sheshi i lagjes “11 Janari”
- Rruga nga Libraria deri te stacioni i autobuzave per ne Berat
- Rruga e re lagjia “1 Maji” (Nga Selvia - shkolla Gaqi Karakashi- sheshi i dyqaneve – rruga ‘Vasillaq Tanku’)
- Rruga e re lagjia “Lllukan Prifti”
- Kryqezimi te Stacioni i autobuzave per ne Berat
- Kryqezimi te sheshi ne hyrje te Lapidari
- Kryqezimet te sheshi i Bashkise
- Kryqezimi te Kendi i Lojrave per Femije
- Kryqezimi te Fotografi
- Kryqezimi te Mapua
- Kryqezimi te Dibranet
- Kryqezimi te Poliambulanca kryesore

- Kryqezimet tek rruga e re lagjies “1 Maji” ((Nga Selvia-shkolla Gaqi Karakashi-sheshi i dyqaneve-Vasillaq Tanku)
- Kryqezimet tek Rruga e re lagjies “Llukan Prifti” (Tek ish shkolla Reiola, shkolla Koco Korcari, sheshi i pallateve – prane ambulances)

Plani i berjes se vijezeve per automjete, vend parkime dhe kembesore mund te ndryshoje gjate kohes se zbatimit te kontrates nga Bashkia, sipas nevojave per permiresimin e sherbimit te dekorit, ose si rezultati ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture.

b.Kontraktuesi eshte i detyruar te zbatoje planin fillestar te vijezeve per automjete dhe kembesore, si dhe cdo ndryshim te tyre, pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate.Ne te gjitha rastet kur kontraktuesi ka nevojte per te permiresuar sherbimin dhe mireorganizuar ate,mund te kerkoje zyrtarisht prane Bashkise ndryshime, te cilat behen te zbatueshme pas miratimit te kerkeses.

c.Grafiku vjetor i punimeve per berjen e vijezeve per automjete dhe kembesore eshte i percaktuar per cdo vit si me poshte:

- Vijezimet per automjete dhe kembesore behen ne muajin qershor te cdo viti, ose ne nje muaj tjeter sipas kerkeses se bashkise.
- oraret e punes per berjen e vijezeve do te jene nga ora 21.⁰⁰- 02.⁰⁰ kohe qe nuk ka levizje te automjeteve.

e.Bashkia ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe grafikun e punimeve dhe ne perfundim rruget, kryqezimet dhe vend parkimet ku jane bere vijezimet per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.

3.4. Rregulla per tu zbatuar.

a.Kontraktuesi duhet te siguroje berjen e vijezeve sipas rregullave te qarkullimit rrugor te percaktuar ne Kodin e Qarkullimit Rrugor te RSH.

b.Ne te gjitha rastet kur evidentohen demtime te vijezeve nga persona te papergjegjshem apo nga faktore te tjere te jashtem, kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per riberjen e tyre e tyre jo me vone se 5 dite nga marrja e njoftimit.Ne rast te kundert, pergjegjesia eshte e kontraktuesit dhe do te vendosen penalitete sipas ligjit.

3.5. Mjetet dhe Paisjet.

Kontraktuesi duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, berjes se vijezeve per mjete dhe kembesore dhe te gjitha sherbimeve plotesuese keto mjete dhe pajisje:

5. Automjet per transportin e bazes materiale
6. Spango dhe shabllone te gatshme per vijeze (metalike ose druri)

4.F.V - tabelash te qarkullimit rrugor, sipas Kodit te Qarkullimit Rrugor te Republikes se Shqiperise.

4.1.Volumet e punimeve.

Bashkia ka parashikuar paraprakisht numrin e tabelave te qarkullimit rrugor prej **30 cope** ne vit, pershkrimin e punimeve dhe specifikimet e tyre, ne analizen e kostos Nr.5, te parashikuara per rregullimin e qarkullimit te automjeteve ne rruget e qytetit.

4.2.Specifikimet teknike dhe metodologjia

Sherbimi i vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor konsiston ne:

- a. Tabelat e qarkullimit rrugor vendosen ne rruge e sheshe kryesore dhe me efekt vizual te drejtuesit e automjeteve, sipas pikave te vendosjes se tyre ne zonen e sherbimit te qytetit Kucove dhe ne rruget e njesive administrative Kozare, Lumas e Perondi.
- b. Tabelat jane standarte, te llojeve e tipeve te ndryshme sipas Kodit te Qarkullimit Rrugor te R.SH, te cilat vendosen ne vende te pershtatshme dhe lehtesisht te dallueshme nga drejtuesit e automjeteve. Ato vendosen ne pozicion vertikal me tubo te vecante metalike me diameter $\Phi 1\frac{1}{4}$ "-1,5" dhe gjatesi 3 ml ose ne shtyllat metalike te ndricimit rrugor, per t'i ruajtur ato nga vjedhjet e personave te papergjegjshem (kjo do te parashikohet edhe ne kontraten midis paleve).

4.3.Plani i vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor.

- a. Bashkia do te percaktoje pikat ekzakte te vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor ne te gjitha zonen e kontraktuar, pra ne rruget e sheshet kryesore te qytetit, dhe te njesive administrative sipas nevojës.
Plani i vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor mund te ndryshoje gjate kohes se zbatimit te kontrates nga Bashkia, sipas nevojave per permiresimin e sherbimit te qarkullimit rrugor te automjeteve, si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture, ose sipas kerkesave specifike te Policise se Qarkullimit Rrugor ne qytetin e Kucoves.
- b. Kontraktuesi eshte i detyruar te zbatoje planin e pikave te vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor, si dhe cdo ndryshim te tyre, pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate. Ne te gjitha rastet kur kontraktuesi ka nevojë per te permiresuar sherbimin dhe mireorganizuar ate, mund te kerkoje zyrtarisht prane Bashkise ndryshime, te cilat behen te zbatueshme pas miratimit te kerkeses.
- c. Plani vjetor i punimeve per realizimin e vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor, pergatitet nga sipermarresi i sherbimit te dekorit dhe supervizori i sherbimeve publike. Plani i vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor mund te pesoje ndryshime sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti.
- d. Ne perfundim te punimeve per vendosjen e tabelave te qarkullimit rrugor mbahet proces - verbal midis supervizorit te bashkise dhe sipermarresit, per numrin, llojin e tabelave dhe vend ndodhjen e tyre.
- e. Bashkia ka te drejte te inspektojë ne cdo kohe grafikun e punimeve dhe ne perfundim vendet e vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoha per mospermbushjen e tyre.

4.4. Rregulla per tu zbatuar.

- a. Kontraktuesi duhet te siguroje vendosjen e tabelave te qarkullimit rrugor ne

lartesine e duhur, ne menyre te dallueshme nga drejtuesit e automjeteve.
b.Ne te gjitha rastet kur evidentohen demtime te tabelave nga persona te papergjegjshem apo nga faktore te tjere te jashtem, kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per zevendesimin e tyre, sipas planit te vendosjes se tyre ne bashkepunim me supervizorin. Ne rast te kundert,pergjegjesia eshte e kontraktuesit dhe do te vendosen penalitete sipas ligjit.

4.5. Mjetet dhe Paisjet.

Kontraktuesi duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, vendosjes se tabelave te qarkullimit rrugor dhe te gjitha sherbimeve plotesuese keto mjete dhe pajisje:

- Automjet per transportin e bazes materiale
- Karroce dore, lopate, leve metalike, mistri, kova etj.

5.F.V - mirembajtje e lapidareve dhe basoreliefeve ne bashkine e Kucoes.

5.1.Volumet e punimeve.

Bashkia ka parashikuar paraprakisht numrin e lapidareve dhe basoreliefeve prej **7 cope** ne vit, pershkrimin e punimeve ne analizen e koston Nr.6, te parashikuar per riparim e lysterje me vend ndodhje si me poshte:

- ne qytetin Kucove - 3 lapidare
- ne njesine Perondi - 2 lapidare
- ne njesine Lumas - 2 lapidare

5.2.Specifikimet teknike dhe metodologjia

Sherbimi i mirembajtjes, riparimit te lapidareve dhe basoreliefeve konsiston ne:

- a. Pastrimi i basorelievit te lapidareve me furce teli per te hequr papastertite dhe krijuar kushtet per lysterjen e tyre.
- b. Riparim i pjeseve te demtuara te basorelievit dhe siperfaqes se fasades se lapidareve gjate vitit nga agjentet atmosferike.
- c. Lysterja komplet e basorelievit me boje speciale (boje e bardhe akrelik ose boje çimentato).
- d. Lysterja komplet e konstruksionit te lapidarit se bashku me shkallet dhe pjeset e tjera (me boje e bardhe akrelik ose boje çimentato).

5.3.Plani i vend ndodhjes se lapidareve e basoreliefeve.

a.Ne bashkine Kucove jane percaktuar vend ndodhjet e lapidareve ne qytetin Kucove dhe ne njesite administrative Lumas e Perondi.

Plani i vendndodhjes se lapidareve e basoreliefeve nuk ndryshon dhe eshte si me poshte:

- Lapidari i Kucoes me vendndodhje ne hyrje te qytetit, prane stadiumit te futbollit
- Lapidari i Greves se Kucoes me vendndodhje ne sheshin e lagjies “11 Janari”
- Basoreliefi kushuar naftetareve me vendndodhje, hyrja e shkalleve te Muzeut, lagjia “T.Skendo”.
- Lapidari i Perondise me vendndodhje prane shkolles se mesme Perondi
- Lapidari i Velagoshtit me vendndodhje ne qender te fshatit
- Lapidari i Lumasit me vendndodhje prane shkolles 9 - vjecare ne Vodez

-Lapidari i Lumasit me vendodhje ne Pashtraj kushtuar Deshmoreve te Atdheut

- b.Kontraktuesi eshte i detyruar te zbatoje planin e mirembajtjes se lapidareve sipas vendndodhjes se tyre, pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate.Ne te gjitha rastet kur kontraktuesi ka nevojte per te permiresuar sherbimin dhe mireorganizuar ate, mund te kerkoje zyrtarisht prane Bashkise ndryshime, te cilat behen te zbatueshme pas miratimit te kerkeses.
- c.Plani vjetor i punimeve per mirembajtjen e lapidareve pergatitet nga sipermarresi i sherbimit te dekorit dhe supervizori i sherbimeve publike.
- d.Ne perfundim te punimeve per mirembajtjen e lapidareve mbahet proces-verbal midis supervizorit te bashkise dhe sipermarresit, per numrin dhe punimet e bera ne cdo lapidar sipas vend ndodhjes se tyre.
- e.Bashkia ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe punimet qe jane kryer ne lapidaret per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mos permbushjen e tyre.

5.4. Rregulla per tu zbatuar.

- a.Kontraktuesi duhet te siguroje mirembajtjen e lapidareve, punimet per pastrimin e siperfaqes se jashtme dhe te basoreliefeve ne tyre me cilesi te mire.
- b.Ne te gjitha rastet kur evidentohen demtime te lapidareve nga persona te papergjegjshem apo nga faktore te tjere te jashtem, kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per riparimin e demit te tyre jo me vone se 5 dite nga marrja e njoftimit.Ne rast te kundert,pergjegjesia eshte e kontraktuesit dhe do te vendosen penalitete sipas ligjit.

5.5. Mjetet dhe Pajisjet.

Kontraktuesi duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, te mirembajtjes se lapidareve dhe te gjitha sherbimeve plotesuese keto mjete dhe pajisje:

- Automjet per transportin e bazes materiale
- Shkalle, pajisje per pastrim, rul per lysterje me boje plastike, kova etj.

Grupi i punës